

20242233915

## ФОНД ЗА ЗДРАВСТВЕНО ОСИГУРУВАЊЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Në pajtim me nenin 54, paragrafi 1, pika 2, nenin 56, paragrafi 1, pika 3, kurse në lidhje me nenin 34, paragrafi 1, nënparagrafi 7, nenin 69 dhe nenin 70, paragrafi 1 të Ligjit të Sigurimit Shëndetësor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” 25/2000, 34/2000, 96/2000, 50/2001, 11/2002, 31/2003, 84/2005, 37/2006, 18/2007, 36/2007, 82/2008, 98/2008, 6/2009, 67/2009, 50/2010, 156/2010, 53/2011, 26/2012, 91/2013, 187/2013, 43/2014, 44/2014, 97/2014, 112/2014, 113/2014, 188/2014, 20/2015, 61/2015, 98/2015, 129/2015, 150/2015, 154/2015, 192/2015, 217/2015, 27/2016, 37/2016, 120/2016, 142/2016 dhe 171/2017 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 275/2019, 77/2021, 285/2021, 60/2023, 154/2023 dhe 209/2023), Këshilli Drejtues i Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 22.10.2024, miratoi

### R R E G U L L O R E

#### **PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES SË KRITEREVE PËR LIDHJEN E MARRËVESHJEVE DHE MËNYRËN E PAGESËS DHE PROCEDURËS PËR REALIZIMIN E TË DREJTËS DHE SHËRBIMET SHËNDETËSORE PËR FEKONDIM TË ASISTUAR BIOMJEKËSOR NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE QË KRYEJNË KUJDES SHËNDETËSOR SPECIALISTIK-KONSULTATIV**

##### Neni 1

Në Rregulloren e kriterëve për lidhjen e marrëveshjeve dhe mënyrën e pagesës dhe procedurës për realizimin e të drejtës dhe të shërbimeve shëndetësore për fekondim të asistuar biomjekësor në institucionet shëndetësore të cilat kryejnë kujdes shëndetësor specialistik-konsultativ (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 5/2024), në nenin 10, paragrafi 1 ndryshohet dhe vijon:

“Institucioni shëndetësor faturon shërbimet shëndetësore sipas çmimeve të paketave për shërbimet shëndetësore të kryera të FAB-së, në pajtim me protokollet e përcaktuara.”

Pas paragrafit 1 shtohen tre paragrafe të reja 2, 3 dhe 4 të cilat vijnë:

“Gjatë ekzistimit të indikacioneve mjekësore për pezullim të përkohshëm të procedurës që mund të vazhdojë, shërbimet shëndetësore të kryera faturohen në Fond, pasi procedura të ketë përfunduar plotësisht, bashkëngjitur me shpjegimin përkatës mjekësor.

Gjatë ekzistimit të indikacioneve mjekësore në pamundësinë e përfundimit të plotë të procedurës, shërbimet shëndetësore për fazën e protokollit në të cilën ka përfunduar procedura FAB, i faturohen Fondit, bashkëngjitur me shpjegimin përkatës mjekësor.

Faturimi i shërbimeve shëndetësore të paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni bëhet për muajin në të cilin janë kryer shërbimet shëndetësore për FAB”.

Paragrafët 2 dhe 3 bëhen paragrafët 5 dhe 6.

##### Neni 2

Në nenin 19 në paragrafin 3, pika 4 fshihet.

Pas paragrafit 3 shtohet paragrafi i ri 4, i cili thotë:

“Të dhënat për të drejtat e FAB-it të shfrytëzuar më parë, si dhe të dhënat për sigurimin shëndetësor dhe numrin e anëtarëve të familjes (fëmijë të lindur në martesë ose jashtë martesë) të parashtruesit të kërkesës, Fondi i siguron sipas detyrës zyrtare”.

Neni 3

Në nenin 21 në paragrafin 1 fjalët “në formularin e përshkruar Njoftim (NJ-FAB)”, fshihen.

Neni 4

Në nenin 22 paragrafi 2 ndryshohet dhe thotë:

“Personi i siguruar duhet ta fillojë procedurën për FAB në institucionin shëndetësor përkatës në periudhën prej 6 muajve nga prani i njoftimit të pranimit.

Neni 5

Në nenin 23 pika E ndryshohet dhe thotë:

“Dokumentacioni shtesë për realizimin e të drejtës së FAB, për gratë e rritura dhe gra të afta afariste që nuk janë të martuara:

- Vërtetime të kapacitetit të paprekur afarist dhe të drejtave prindërore të paprekura - të lëshuar nga gjykata themelore kompetente;
- Vërtetim për mosgjykim - të lëshuar nga gjykata penale kompetente dhe
- Vërtetim për aftësisë për përkujdesje prindërore - e lëshuar nga qendra kompetente për çështjet sociale”.

Neni 6

Neni 24 ndryshohet dhe thotë:

“Në varësi të dokumentacionit mjekësor dhe mendimit profesional të Komisionit të FAB-it, lëshohet njoftim për realizimin e të drejtës së FAB-it për një nga protokollet e mëposhtme:

1. Protokoll standard për FAB
2. Protokoll për FAB me qeliza vezë të kriopservuara (personale ose donatore)
3. Protokoll për FAB me spermatozoa të kriopservuara (personale ose donatore)
4. Protokoll për FAB me transferimin e embrionit të embrioneve të kriopservuara (personale ose donatore)
5. Protokoll për FAB me bartës gestacional
6. Protokoll për FAB me qeliza vezë të kriopservuara (personale ose donatore) mund të përdoret gjithashtu për procedurat FAB kur përveç qelizave vezë të kriopservuara (personale ose donatore), përdoren spermatozoid të kriopservuara (personale ose donatore).”

Neni 7

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe do të publikohet pas marrjes së pëlqimit të ministrit të Shëndetësisë.

Nr. 02-23322/5  
24.10.2024  
Shkup

Bordi drejtues  
Kryetar,  
**Dejan Nikolovski, d.v.**